STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për Njoftim të Menjëhershëm: 24 janar 2013

GUVERNATORI KUOMO (CUOMO) NJOFTON ZGJATJEN E NDIHMES PER STREHIMIN DHE ATE INDIVIDUALE PER VIKTIMAT E URAGANIT SENDI (SANDY)

Programi i Ndihmës për Strehimin e Përkohëshëm zgjatet për NY për 14 ditë të tjera, Programi i Ndihmës Individuale zgjatet për 30 ditë

Guvernatori Endrju M. Kuomo (Andrew M. Cuomo) njoftoi sot se Agjencia e Administrimit të Ndihmës Federale (Federal Emergency Management Agency) (FEMA), me kërkesë të Shtetit të Nju Jorkut (State of New York), ka miratuar një zgjatje prej 14 ditësh të programit të Ndihmës për Strehimin e Përkohëshëm (TSA) dhe një zgjatje prej 30 ditësh të programit të Ndihmës Individuale (IA). Ky veprim do t'u lejojë të mbijetuarve të Uraganit Sendi (Sandy) që kualifikohen, të cilët nuk mund të kthehen në shtëpitë e tyre, të qëndrojnë në hotelet ose motelet që marrin pjesë në këtë program dhe do t'u lejojë individëve që kualifikohen aftësinë që të marrin ndihmë federale për riparimin e pronave të dëmtuara të tyre.

Zgjatja e re e TSA do t'ju lejojë aplikuesve që të qëndrojnë në hotelet që marrin pjesë në këtë program deri më 9 shkurt 2013. FEMA do t'u telefonojë aplikuesve që kualifikohen për zgjatjen për t'i njoftuar ata për periudhën e zgjatur 14 ditore dhe për datën e largimit, 10 shkurt 2013.

Zgjatja e IA do të sigurojë 30 ditë të tjera për individët dhe bizneset që të bëjnë kërkesë tek FEMA për ndihmë për riparime të shtëpisë dhe nevoja të tjera dhe tek Administrata e Bizneseve të Vogla për hua.

"Mbetemi të përkushtuar që të ndihmojmë të gjitha viktimat e Uraganit Sendi (Sandy), që të sigurojmë se kanë strehimin që u nevojitet, veçanërisht në këtë mot të ftohtë," tha Guvernatori Kuomo (Cuomo). "Programi i Ndihmës për Strehimin e Përkohëshëm do të vazhdojë të sigurojë strehim për ata banorë të Nju Jorkut (New Yorkers) që nuk kanë shtëpi ku të kthehen dhe për të ndihmuar të tjerët me financimin mjaft të nevojshëm për të rindërtuar."

TSA është një progam afat-shkurtër që vendos familje në hotele ndërsa punojnë drejt një plani të strehimit me afat më të gjatë. Individët duhet të hyjnë në program deri më 26 janar 2013 për t'u kualifikuar.

Për t'u kualifikuar për Programet e FEMA, të mbijetuarit fillimisht duhet të bëjnë kërkesë për ndihmë federale nëpërmjet FEMA duke:

- U rregjistruar në internet në **www.DisasterAssistance.gov**;

- U rregjistruar nëpërmjet telefonave të zgjuar ose kompjuterave portative duke përdorur aplikacionin e FEMA ose duke shkuar tek **m.fema.gov**; ose

- U rregjistruar duke telefonuar në **800-621-FEMA** (3362) (TTY 800-462-7585). Për 711 ose Shërbimin e Stafetës Video (VRS), telefononi në 800-621-3362.

###

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418